

## Vendim nr. 6 datë 14.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 14.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** VALBONA HAJDARI, përfaqësuar nga avokat Roland Islami, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 373 (2387), datë 16.05.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; nr. 1298 (30-2024-4328), datë 04.06.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 00-2024-1358, datë 23.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për caktimin e masës së sigurimit.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në fazën e ekzekutimit të vendimit nr. 373 (2387), datë 16.04.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në lidhje me kompetencën e ekzekutimit.

Parashtrimi për zgjidhje i mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit gjyqësor (prokurorit dhe oficerit të Policisë Gjyqësore), si dhe pushtetit ekzekutiv (Ministrisë së Drejtësisë) për ekzekutimin e masës së sigurimit “Pezullimi i

ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale në rastin e noterit, duke përcaktuar pushtetin gjyqësor si pushtetin kompetent për ekzekutimin e vendimit nëpërmjet oficerit të Policisë Gjyqësore.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është licencuar nga Ministria e Drejtësisë për ushtrimin e funksionit të noteres publike.

2. Në kuadër të një hetimi që është duke u zhvilluar, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (*prokuroria*) ka krijuar dyshimin e arsyeshëm se kërkuesja gjatë ushtrimit të funksionit ka noterizuar kopje të falsifikuara të shumë prokurave të posaçme. Sipas saj, duke qenë se vepra penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186, paragrafi 3, i Kodit Penal (*KP*) është konsumuar në vitin 2006, referuar neni 66, paragrafi 1, shkronja “c”, të KP-së, vepra penale është parashkruar. Megjithatë, meqenëse në vitin 2022 kërkuesja ka pajisur palën e interesuar me kopje të noterizuar të dokumenteve të falsifikuara nga vetë ajo, prokuroria ka çmuar se kishte të bënte me konsumimin e kësaj vepre penale përsëri. Për rrjedhojë, prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. 657, datë 10.05.2022, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar përkatësisht nga nenet 186 dhe 248 të KP-së.

3. Në datën 15.05.2024 rezulton se prokurori i çështjes ka paraqitur në Gjykatën e

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër kërkesën për caktimin ndaj të dyshuarës (kërkueses) të masës së sigurimit personal “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, sipas nenit 242 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Në vijim, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 373 (2387), datë 16.05.2024, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik“, në ngarkim të shtetases Valbona Hajdari, si person i dyshuar për kryerën e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesja.

5. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1298 (30-2024-4328), datë 04.06.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit dhe dërgimin e akteve në gjykatën e shkallës së parë me qëllim zhvillimin e seancës për verifikimin e kushteve dhe kritereve të masës së sigurimit brenda 5 ditëve nga marrja e akteve. Ajo gjykatë ka konstatuar se nga aktet e përcjella ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka njoftuar kërkuesen për vendimin e marrë ndaj saj, duke vënë në diskutim çështjen e pranueshmërisë për shqyrtim të ankimit. Në rastin në shqyrtim, ajo gjykatë ka konstatuar paraprakisht një gabim të gjyqtarit të hetimit paraprak, i cili nuk ka urdhëruar sekretarinë e gjykatës që të komunikojë vendimin për personin nën hetim, por ka urdhëruar prokurorin për ekzekutimin e vendimit. Për rrjedhojë, ankuesja është njoftuar për vendimin e marrë dhe masën në ngarkim të saj nga prokurori i çështjes, duke paraqitur në këto kushte edhe ankimin ndaj atij vendimi. Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar se duke vepruar kështu, gjykata e shkallës së parë ka shmangur ushtrimin e kompetencës së saj për të kompletuar procesin gjyqësor nëpërmjet dëgjimit të personit nën hetim dhe verifikimin e kushteve dhe kritereve të masës së caktuar. Ky është, sipas saj, pikërisht momenti kur personi ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit mund t’i parashtrojë gjykatës të gjitha pretendimet e tij për procesin penal, duke bërë kështu edhe kërkimet konkrete për atë që duhet të vendoset. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka evidentuar se, sipas parashikimeve të nenit 248 të KPP-së e drejta e ankimit për të pandehurin (pa përjashtuar prokurorin) parashikohet vetëm ndaj vendimit të gjykatës të marrë pas seancës së pyetjes. Në përfundim, gjykata e apelit ka vlerësuar se pa u zhvilluar seanca e marrjes në pyetje dhe e verifikimit të kushteve dhe kritereve nga vetë gjykata që e ka caktuar masën e sigurimit, kërkuesja nuk mund t’i drejtohet gjykatës së apelit me ankim. Për të garantuar rregullshmërinë e procesit dhe riparimin e gabimeve të bëra, gjykata e apelit ka urdhëruar kthimin e akteve në gjykatën e shkallës së parë dhe marrjen në pyetje të kërkueses brenda 5 ditëve nga marrja e akteve. Kundër atij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në datën 23.07.2024 ka marrë në shqyrtim në

dhomën e këshillimit rekursin e kërkuases dhe me vendimin nr. 00-2024-1358, ka vendosur mospranimin e tij për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Ajo gjykatë ka arsyetuar se gjykata e apelit ka evidentuar një shkelje procedurale të gjykatës së shkallës së parë dhe në mënyrë të qartë ka sqaruar hapat proceduralë që ajo gjykatë duhet të marrë në konsideratë për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Sipas saj, me të drejtë, gjykata e apelit ka arsyetuar se pa u zhvilluar seanca e marrjes në pyetje dhe verifikimi i kushteve e kritereve nga vetë gjykata që e ka caktuar masën, kërkuësja nuk mund t'i drejtohet gjykatës së apelit me ankim.

7. Në datën 31.10.2024 kërkuësja, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 13.11.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuases

8. *Kërkuësja*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1. *E drejta e aksesit në gjykatë*, pasi kjo e drejtë nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi. Zbatimi i gabuar i dispozitave të KPP-së ka sjellë mosgjykimin e thelbit të pretendimeve të kërkuases nga gjykatat e fatit, të cilat i kanë mohuar asaj të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës.

8.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi gjykatat e faktit kanë dhënë vendime të padrejta dhe jo objektive. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë një masë sigurimi të pavlefshme dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 248 të KPP-së, pasi masa është dhënë në dhomën e këshillimit, pa u marrë në pyetje personi ndaj të cilit është dhënë masa, duke cenuar kështu edhe *të drejtën e pyetjes dhe marrjes dijeni për masën e sigurimit*. Gjykata e apelit tregohet e njëanshme kur argumenton se dërgimi i akteve dhe verifikimi i kushteve duhet të bëhet brenda 5 ditëve nga kalimi i akteve gjykatës së shkallës së parë, ku në fakt afati duhet të fillonte nga zbatimi i masës. Ndërsa Gjykata e Lartë ka cenuar *të drejtën e marrjes së deklarimeve* të personit ndaj të cilit është caktuar masa.

8.3. *E drejta për t'u dëgjuar, e garantuar nga neni 33 i Kushtetutës*, pasi gjykatat e faktit i kanë mohuar të drejtën e kërkuases për t'u dëgjuar gjyqësisht për të drejtat e saj

në procesin penal, duke bërë dhe kërkuar ekzekutime të një vendimi të marrë në dhomën e këshillimit.

- 8.4. *E drejta e ankimit*, pasi gjykata e apelit anashkalo me dashje cenimin e ligjit nga gjykata e shkallës së parë, pasi pavarësisht se argumenton se pretendimi i ngritur në ankim gjën mbështetje, vendos mospranimin e ankimit. Pas mospranimit të ankimit, gjykata nuk ka më akt për të vendosur dhe çdo gjë që vendos pas kësaj është abuzive dhe në mungesë të kompetencës.
- 8.5. *Garancitë procedurale të parashikuara nga neni 31 i Kushtetutës*, pasi për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal, ndaj kërkueses është caktuar një masë sigurimi personal edhe pse ajo nuk rezulton si person nën hetim. Gjykata e shkallës së parë ia ka mohuar të gjitha këto garanci kërkueses, ndërsa gjykata e apelit nuk i ka shqyrtuar fare ato.
- 8.6. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi në caktimin e masës së sigurimit në gjykatën e shkallës së parë nuk janë vlerësuar drejt rrethanat e faktit. Ndërsa gjykata e apelit, fillimisht, ka ftuar kërkuesen të marrë dijeni për vendimin dhe pasi është vënë në dijeni se ajo ishte njoftuar për vendimin me urdhër ekzekutimi nga prokurori, ka marrë në shqyrtim ankimin dhe, pa marrë asnjë deklaram të palëve, ka vendosur mospranimin e tij. Ajo gjykatë nuk merret me shkaqet e ankimit, duke e lënë të paargumentuar vendimin e saj, si dhe shprehet në kundërshtim me objektin e ankimit kur citon se masa e sigurimit duhet të verifikohet brenda 5 ditëve. Vendimi i asaj gjykate është abuziv dhe pa asnjë shkak objektiv. Ajo gjykatë ka vendosur në mënyrë të gabuar për dërgimin e akteve gjykatës së shkallës së parë për verifikimin e kushteve, pa e prishur atë vendim.
- 8.7. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zbatuar gabim ligjin procedural dhe material, pasi:
- 8.7.1. Neni 228 i KPP-së parashikon se askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova, ndërsa në rastin konkret organi i akuzës ka bërë kërkesë, të cilën gjykata e ka pranuar, për të caktuar masë ndaj kërkueses edhe pse nuk është person nën hetim. Organi i akuzës nuk e ka pyetur asnjëherë kërkuesen si person ndaj të cilit po zhvillohen hetime, për më tepër që në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit ajo cilësohet si "shtetase" dhe jo "person nën hetim".

8.7.2. Ato kanë keqzbatuar nevojën e sigurimit të diktuar nga dyshimi i akuzës, duke caktuar një masë ndaluese pa qenë nevoja për masa shtrënguese. Për më tepër, nuk është argumentuar në mënyrë të arsyeshme se si nxjerrja nga arkivi i një dokumenti të padeklaruar të falsifikuar, të pasekuestruar ose asgjësuar të përbëjë veprë penale, në kushtet kur aktet e pretenduara si të falsifikuara janë akte të lëshuara në kompetencë të noterit dhe në përputhje me ligjin për noterinë.

8.7.3. Neni 66 i KP-së përcakton se asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie të shuarjes së veprës penale ose të dënimit. Në rastin konkret, ndjekja penale për veprën penale të falsifikimit është parashkruar, arsye për të cilën organi i akuzës e ka lidhur në mënyrë të paarsyeshme caktimin e masës me njësimin e dokumenteve të ndodhura në arkivin e noteres (kërkueses).

8.8. Prokuroria ka marrë kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë, duke i kërkuar kësaj të fundit të zbatojë një vendim gjykate, i cili nuk është në kompetencë të saj, por zbatohet drejtpërsëdrejti nga oficeri i Policisë Gjyqësore. Në këto kushte lind nevoja që gjykata të përcaktojë se cili pushtet ka kompetencën për ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna në dhomën e këshillimit, pushteti gjyqësor ose ai ekzekutiv.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik subjekt i së drejtës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë njëkohësisht kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

11. Në këtë këndvështrim, kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës. Ky kriter nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin *subsidiar* që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuësja ka kundërshtuar procesin gjyqësor lidhur me caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të saj. Në lidhje me këtë, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuëses, ndërsa gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit dhe dërgimin e akteve në gjykatën e shkallës së parë, me qëllim që kjo e fundit të riparojë gabimet procedurale të konstatuara nga gjykata e apelit dhe të konfirmuara nga Gjykata e Lartë, duke zhvilluar seancën për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të masës së sigurimit brenda 5 ditëve nga marrja e akteve. Në kushtet kur çështja është kthyer nga gjykata e apelit në gjykatën e shkallës së parë, Kolegji konstaton se procedurat gjyqësore për shqyrtimin e masës së sigurimit në ngarkim të kërkuëses nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

14. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuësja nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

15. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.